



C.nr.163/2015

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen juridike të paditësit [REDACTED] nga Ferizaj, kundër të paditurës Telekom i Kosovës SH.A Prishtinë, të cilën e përfaqëson [REDACTED] nga Ferizaji, baza juridike pagesa e të ardhurave personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë më datë 05.01.2017, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESERISHT APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadija e paditësit [REDACTED] dhe **DETYROHET** e paditura Telekom i Kosovës SH.A Prishtinë, që paditësit [REDACTED], t'ia paguajë shumën e të hollave prej 4057,34 euro, me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data 01.01.2017 deri në pagesën definitive.

II. Detyrohet e paditura Telekom i Kosovës SH.A Prishtinë që paditësit [REDACTED] në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën e të hollave prej 120 euro.

III. REFUZOHET SI E PA BAZUAR pjesa e kërkesëpadiës së paditësit [REDACTED] me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura Telekom I Kosovës Sh.A në Prishtinë që paditësit [REDACTED] të ia paguajë shumën e të hollave prej 948.78 euro, me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga data 01.01.2017 e deri në pagesën definitive, si dhe refuzohet si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadiës së paditësit me të cilin ka kërkuar që ti kthehet grada nga 5 në gradën 6.

IV. Detyrohet paditësi [REDACTED] që kësaj gjykate në emër të taksës gjyqësore për aktgjykim t'ia paguajë shumën e të hollave prej 50 euro.

A r s y e t i m

Paditësi [REDACTED] në këtë gjykatë, ka parashtruar padi, kundër të paditues Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës në Prishtinë, tani me emërtimin Telekom i Kosovës SH.A Prishtinë.

Paditësi në padi ka theksuar: Paditësi ka lidhë me të paditurin kontratën e punës e cila është protokolluar me nr.01-2880-359/2011, të datës 20.10.2011. Në nenin 4 të kësaj

kontrate parashihet që paditësi për punën e kryer të kompensohet me pagë të përcaktuar nga grada 6, kurse me vendimin e burimeve njerëzore me E_mail dhe nuk gjendet në dosje në Ferizaj, andaj kërkoj nga e paditura që Aktvendimin ta sjellë në Gjykatë të datës 07.03.2012 ku paditësit i caktohet grada 5.

Paditësi në afatin e paraparë në nenin 87, 78, dhe 79 të ligjit të punës ka inicuar proceduarat e duhura për të plotësuar kushtet për iniciimin e procedurës gjyqësore me padi në gjykatë, duke paraqitur kërkesë për kthimin e gradës dhe ankesë kundër vendimit nr.” Vendimi mbi uljen e gradës, të datës 07.03.2012 i cili nuk më është dhënë, por jam i njoftuar vetëm në E_mail, dhe nuk gjendet në dosje në Ferizaj, andaj kërkoj nga e paditura që aktvendimin ta sjellë në Gykatë”.

Paditësi është dëmtuar në mënyrë të kundërligjshme në page në shumën 80 euro për qdo muaj duke filluar nga paga e muajit shkurt e vitit 2012 si dhe në muajt në vazhdim edhe për shkak të zvoglimit të kontributeve në trust, në lartësinë 40 euro për qdo muaj, duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2012 si dhe në muajt në vazhdim.

Duke u bazuarë në faktet e parashtruara më lartë, për shkak të shkeljes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit me vendim arbitrarë, të marrë me aktvendimin , vendimin mbi uljen e gradës, të datës 07.03.2012 i cili nuk më është dhënë, por jam i njoftuar vetëm me E_mail, dhe nuk gjendet ne dosje në Ferizaj, andaj kërkoj nga e paditura që aktvendimin ta sjellë në gjykatë. Në afatin e paraparë në nenin 87 dhe nenin 79 të ligjit të punës, paditësi ka paditësi ka paditë PTK-në.

Paditësit [REDAKTUAR], ka kërkuar nga Gjykata që ta detyrojë të paditoren Telekom i Kosovës që paditësit të ja paguajë shumën prej 5006.12 euro, me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data 01.01.2017 deri në pagesën definitive. Si dhe ka kërkuar ti kthehet grada nga 5 në graden 6.Po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura përmesë përfaqësueses së saj [REDAKTUAR] ka theksuar e kontestoj bazën ligjore të padisë dhe kërkesëpadisë nga se e njejta është e pabazuar, ashtu që i propozojë Gjykatës që të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të refuzojë si të pabazuarë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe sa më të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje civilo-juridike gjatë shqyrtimit gjyqësorë janë administruarë si provë: Kontrata e punës e 2011, kontrata e punës e datës 22.12.2015, ekspertiza e ekspertit financiar [REDAKTUAR]

në bazë të nenit 55 të ligjit të punës dhe nenit 5 të kontratës në fjalë ka të drejtë ti realizojë të ardhurat personale të parapara me këtë kontratë dhe Gjykata me vendimet e saja nuk mundet ti ndryshojë kontratat e punës sepse kontrata është akt i palëve e jo i Gjykatës. Nga përmbajtja e kontratës së datës 22.12.2015 rezulton se e njejta ka hyre në fuqi me datë 01.01.2016.

Gjykata ka vlerësuar edhe thënjet e të paditurës kur ka theksuar se kërkespadija e paditësit është parashkruar, mirëpo kjo gjykatë këto thënje i quan të pabazuar edhe atë nga arsyet si në vijim: nga deklarata e paditësit i dëgjuar në cilësi të palës gjykata ka vërtetuar se paditësi me datë 22.01.2015 ka parashtruar kërkesë të e paditura me të cilën ka kërkuar t'i kthehet grada nga 5 në 6 si dhe ti paguhet të ardhurat e porealizuara personale dhe nga data 01.02.2012 e deri me datën 22.01.2015 nuk ka kaluar afati 3 vjeçar, deklaratës në fjalë gjykata i'a falë besimin sepse e njejta nuk është kundërshtuar nga e paditura edhe pse i është dhënë mundësia ta kundërshtojë. E përveq kësaj paditësi me date 19.03.2015 ka paraqitur edhe padi në Gjykatë.

Gjykata, duke u bazuar në nenet 452.3, 454.1 të LPK-së, e ka detyruara palën e paditoren që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore për ekspertizën financiare, për taksën për padi në vlerë prej 120 euro.

Vendimi për taksë gjyqësore për aktgjykim si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi është bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Me datë 05.01.2017

Gjyqtari

Barim Emerllahu




UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK : kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmes të kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
ODLUKA JË PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ ILUROŠEVAC

Më
Dana

15.01.18



- Acnr. 802/17